



Strategjia e EASO-s për Bashkëpunim të Jashtëm



Strategjia e EASO-s për Bashkëpunim të Jashtëm

Shkurt 2019

Neither EASO nor any person acting on behalf of EASO is responsible for the use that might be made of the following information.

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2019

Print	ISBN 978-92-9485-291-5	doi:10.2847/583067	BZ-02-19-385-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9485-297-7	doi:10.2847/11600	BZ-02-19-385-SQ-N

© European Asylum Support Office, 2019

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

For any use or reproduction of photos or other material that is not under the EASO copyright, permission must be sought directly from the copyright holders.

Përmbajtja

1. ROLI I EASO-s NË DIMENSIONIN E JASHTËM TË SISTEMIT TË PËRBASHKËT EVROPIAN TË AZILIT.....	4
2. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	5
3. PARIMET UDHËHEQËSE.....	6
4. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE TË VEPRIMIT TË JASHTËM TË EASO-s.....	7
5. KUADRI PËR ZBATIMIN E MBËSHTETJES.....	9
5.1. Parakushtet e angazhimit.....	10
5.2. Procesi i angazhimit të EASO-s.....	10
5.3. Përparësitë gjeografike.....	11
5.4. Llojet e veprimit të jashtëm të EASO-s.....	13
5.5. Instrumentet e bashkëpunimit.....	15
5.6. Marrëveshjet e bashkëpunimit.....	16
5.7. Financimi.....	16
6. BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA.....	17
6.1. Vendet BE+.....	17
6.2. Vendet e treta.....	17
6.3. Institucionet dhe agjencitë evropiane.....	17
6.4. Organizatat ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara kyçe.....	18
7. PLANIFIKIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	19
7.1. Kuadri kohor.....	19
7.2. Metodologjia e planifikimit.....	19
7.3. Monitorimi dhe vlerësimi.....	20

A close-up photograph of a person's back wearing a dark blue jacket with the white text 'Support is our Mission' printed on it. The person is also wearing a red jacket underneath. The background is blurred, showing other people in similar attire.

1. ROLI I EASO-s NË DIMENSIONIN E JASHTËM TË SISTEMIT TË PËRBASHKËT EVROPIAN TË AZILIT

Zbatimi i suksesshëm i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS) varet së pari nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe nga sistemet e tyre të azilit dhe të pritjes, diçka që Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin (EASO) e mbështet vazhdimisht (dimensioni i brendshëm).

Kjo strategji përcakton kuadrin e përgjithshëm brenda të cilit EASO do të zhvillojë punën e saj në lidhje me dimensionin e jashtëm të CEAS. Rregullorja e EASO-s ⁽¹⁾ i jep agjencisë mandatin për të bashkërenduar shkëmbimin e informacionit dhe të veprimeve të tjera të lidhura me dimensionin e jashtëm të CEAS, përfshirë zhvendosjen, në marrëveshje me

Komisionin Evropian. Më tej, EASO mund të bashkëpunojë me autoritetet kompetente të vendeve të treta për çështje teknike, në veçanti me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e ngritjes së kapaciteteve në sistemet e azilit dhe pritjes të vendeve të treta dhe veprimet e tjera që lidhen me zgjidhje të qëndrueshme.

Reforma e CEAS që po kryhet përfshin, ndër të tjera, propozime legjislative të cilat kanë për qëllim themelimin e një Agjencie të mirëfilltë të Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ⁽²⁾ dhe krijimin e Kuadrit të përhershëm të Bashkimit Evropian për Shpërnguljen ⁽³⁾, çka do të ndikojë në veprimet e ardhshme të agjencisë në

⁽¹⁾ Rregullorja (BE) Nr 439/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 Maj 2010 me të cilën themelohet Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin, Neni 7 dhe 49.

⁽²⁾ KOM (2016) 271: Propozim për Rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin, shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr 439/2010 dhe propozim i Komisionit për ndryshimin e Rregullores për EUAA më 12 shtator 2018.

⁽³⁾ Propozim për Rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ngritjen e Kuadrit të BE-së për Zhvendosjen dhe për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr 516/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit [KOM (2016) 468 final].

dimensionin e jashtëm. Në mënyrë të veçantë, parashikohet se agjencia mundet:

- të mbështesë Shtetet Anëtare në zbatimin e Kuadrit të BE-së për Shpërnguljen si dhe skemat kombëtare të zhvendosjes me kërkesë të Shtetit Anëtar përkatës;

- të caktojë specialistë të ndërlidhjes në shtetet e treta ⁽⁴⁾.

Kjo strategji parashikon mundësinë e rishikimit (shih seksionin 7) dhe të miratimit në të ardhmen të propozimit përkatës të legjislacionit për themelimin e EUAA-së së mirëfilltë.

2. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Veprimi i jashtëm i EASO-s bën pjesë në përpjekjen gjithëpërfshirëse për të rritur efektshmërinë e CEAS, në pajtim me politikën e jashtme të Bashkimit Evropian (BE). Ai plotëson përpjekjet e shteteve të BE+ ⁽⁵⁾ në dimensionin e jashtëm, si dhe mbështetjen e EASO-s për zbatimin e CEAS në dimensionin e tij të brendshëm.

Në përputhje me rolin e saj si qendër ekspertize për azilin dhe pritjen, EASO do të zbatojë veprimin e jashtëm duke synuar që të rritet solidariteti dhe ndjenja e përgjegjësisë ndër vendet BE+ si dhe ndërmjet vendeve BE+ dhe vendeve të treta, në frymën e partneritetit dhe shkëmbimeve të anasjella të ekspertizës dhe përvojës.

Për këtë qëllim, objektivat strategjike të veprimit të jashtëm të EASO-s janë:

Kontribuimi në krijimin dhe/ose forcimin e sistemeve të azilit dhe të pranimit si dhe menaxhimin e migrimit të ndjeshëm në vendet e treta, për të mbrojtur më mirë azilkërkesit dhe refugjatët.

Lehtësimi i përpjekjeve të vendeve BE+ në ofrimin e qasjes në BE të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare me fokus në risistemim dhe rrugët e tjera ligjore që çojnë në mbrojtjen ndërkombëtare.

Lehtësimi i shkëmbimit të informatave dhe përvojave në lidhje me dimensionin e jashtëm të CEAS mes vendeve BE+.

⁽⁴⁾ Specialistët e ndërlidhjes do të caktohen në shtetet e treta në të cilat praktikat e migracionit dhe të azilit janë në përputhje me standardet e pacenueshme të të drejtave të njeriut. Përparësi do të kenë ato shtete të cilat përbëjnë vend origjine ose tranziti për migracionin e lidhur me azilin.

⁽⁵⁾ Shtetet Anëtare të BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

3. PARIMET UDHËHEQËSE

Në pajtim me rregulloren e saj, veprimi i jashtëm i EASO-s do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

Qasja lidhur me procedurat mbrojtëse

Veprimi i jashtëm i EASO-s do të realizohet sipas qasjes së procedurave mbrojtëse, në pajtim me rregulloren e EASO-s.

Koherenca me legjislacionin dhe politikat evropiane

Veprimi i jashtëm i EASO-s do të jetë në pajtim me politikat dhe përparësitë e BE-së, për marrëdhëniet e jashtme, ku do të merret parasysh koherenca e politikave për zhvillimin. Me veprimet e saj EASO mbështet ndikimin tërësor të rezultateve të projektuara të BE-së në dimensionin e jashtëm. Veprimi i jashtëm i EASO-s do të bazohet në vlerësimin gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor dhe të politikave evropiane dhe do të zbatohet në marrëveshje me Komisionin dhe në pajtim me organizimin institucional të EASO-s. Në të gjithë veprimin e saj të jashtëm EASO do t'u japë avancojë standardet ligjore dhe operacionale të CEAS.

Qëndrueshmëria, efektiviteti dhe efikasiteti i mbështetjes

EASO është e angazhuar të sigurojë qëndrueshmërinë e ndikimit të saj përmes sigurimit të veprimit efektiv dhe efikas të jashtëm, sipas metodologjisë së menaxhimit të ciklit të projektit. Veprimi i jashtëm i EASO-s do të planifikohet në bazë të vlerësimit të nevojave ose të realizueshmërisë dhe në bazë të një kuadri të qartë rezultatesh për të matur dhe monitoruar ndikimin e saj. Ajo do të ndjekë qasjet e menaxhimit të bazuar në rezultate dhe në teorinë e ndryshimit ⁽⁶⁾ siç përshkruhet në Manualin Operacional të EASO-s ⁽⁷⁾ dhe siç zbatohet, sipas rastit, në veprimin e jashtëm të EASO-s.

Partneriteti, bashkëpunimi dhe interesi i përbashkët

Veprimi i jashtëm i EASO-s duhet të zhvillohet dhe zbatohet në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me vendet BE+, me Komisionin, me Shërbimin e Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), me agjencitë e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme (JHA) të BE-së dhe rrjetin e tyre dhe, aty ku është me rëndësi, në partneritet me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe aktorë të tjerë me peshë kur bashkëpunimi mund të përmirësojë rezultatin e aktiviteteve të planifikuara ose të kryera.

Veprimi i jashtëm i EASO-s duhet të krijojë vlerë të shtuar dhe jo të dublojë përpjekjet e bëra nga partnerët apo grupet e tjera të interesit. Për të garantuar karakterin plotësues dhe për të përfutur nga metodologjitë e zhvilluara tashmë do të përdoret shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e duhura të komunikimit në të cilat përfshihen vendet BE+, Komisioni dhe grupet e tjera të interesit. Veprimi i jashtëm i EASO-s do të zhvillohet në frymën e interesit të ndërsjellë me vendet BE+ dhe me vendet e treta përkatëse për të përballuar sfidat e përbashkëta, duke garantuar pajtueshmërinë me politikat e jashtme të BE-së.

⁽⁶⁾ Për planifikimin e kornizave, programeve dhe projekteve strategjike përdoret qasja e menaxhimit të bazuar te rezultatet. Për fazën e planifikimit përdoren disa mjete si: matrica e rezultateve, plani i monitorimit dhe vlerësimit, planifikimi me bazë skenari dhe strategjia për uljen e riskut. Teoria e ndryshimit është metoda që shpjegon se si një ndërhyrje e dhënë mund të çojë drejt ndryshimeve zhvillimore specifike, duke u mbështetur te rrugëtimi shkakësor bazuar në provat dhe supozimet në dispozicion. EASO ka për synim të përdorë, aty ku shihet e përshtatshme, teorinë e ndryshimit për të miratuar projektin e ndërhyrjes së ndodhur sipas qasjes së menaxhimit të bazuar në rezultate.

⁽⁷⁾ Manuali Operacional (në fazë zhvillimi) synon të udhëzojë personelin operacional të EASO-s se si të kryejë funksionet e veta në mënyrë të efektshme dhe frytdhënëse. Manuali dokumenton procedurat standarde operacionale të miratuara.



4. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE TË VEPRIMIT TË JASHTËM TË EASO-S

Rregullorja aktuale e EASO-s përbën kuadrin ligjor të veprimit të jashtëm të EASO-s. Kjo strategji merr parasysh edhe propozimet përkatëse legjislative që po negociohen aktualisht që kanë për objektiv themelimin e EUAA-së së mirëfilltë dhe krijimin e Kuadrit të përhershëm të BE-së për Shpërnguljen, siç përshkruhet në seksionin 1. Kuadri i politikës të veprimit të jashtëm të EASO-s përcaktohet nga politikat dhe qasjet e BE-së⁽⁸⁾ ku përfshihen:

- **Kuadri i Partneritetit për Migracionin (MPF)**, prezantuar në qershor 2016, i cili trupëzon plotësisht temën e migracionit

në politikën e jashtme evropiane⁽⁹⁾. Ky Kuadër ndjek objektivat e vëna nga Agjenda Evropiane për Migracionin dhe është mjet i fuqishëm për të angazhuar vende të treta strategjike të transitit dhe origjinës në një dialog për migracionin. Kuadri mundohet të forcojë kufijtë e jashtëm, të rrisë numrin e riatdhesimeve të emigrantëve të parregullt, të trajtojë shkaqet kryesore të migracionit dhe të krijojë rrugë ligjore mbrojtjeje për njerëzit në nevojë, përfshirë shpërnguljen. Kuadri i Partneritetit merr formën e **kompekteve** të përshtatura enkas të BE-së⁽¹⁰⁾ të cilat lidhen me veprimin e jashtëm të EASO-s, për aq kohë

⁽⁸⁾ Lista nuk është shteruese dhe pasqyron ecurinë në momentin kur është shkruar ky dokument (shkurt 2019). Kuadri i politikave do të rifreskohet sipas nevojës në kontekstin e rishikimit të strategjisë (shih seksionin 7).

⁽⁹⁾ Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian, Këshillin dhe Bankën Evropiane të Investimeve për ngritjen e një Kuadri të ri Partneriteti me vendet e treta nën Agjendën Evropiane për Migracionin [COM (2016)385 final]; Raporti i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian dhe Këshillin, Raporti i Katërt i Progresit për Kuadrin e Partneritetit me vendet e treta nën Agjendën Evropian për Migracionin [COM(2017) 350 final].

⁽¹⁰⁾ Kompaktet janë “kuadri politik për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe operacional, duke bashkuar linjat e ndryshme të punës për të zhvilluar një partneritet gjithëpërfshirës me vendet e treta, duke kombinuar instrumentet, mjetet dhe levat që disponon BE-ja dhe Shtetet Anëtare për të prodhuar objektiva të qarta dhe angazhime të përbashkëta”. Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian dhe Këshillin Raporti i Parë i Progresit për Kuadrin e Partneritetit me vendet e treta nën Agjendën Evropiane për Migracionin [COM(2016) 700 final].

sa merren me azilin dhe refugjatët në zonat përkatëse gjeografike (seksioni 5.3). MPF-ja përbën bazën e Partneritetit të Lëvizshmërisë (Mobility Partnership) i propozuar nga **Qasja Globale për Migracionin dhe Lëvizshmërinë (GAMM)** ⁽¹¹⁾ në të cilën përcaktohet përcimi i dialogut dhe bashkëpunimit me vendet e treta. Veçanërisht shtylla e tretë i referohet nxitjes së mbrojtjes ndërkombëtare dhe rritjes së dimensionit të jashtëm të politikave të azilit, të cilat EASO ka marrë mandat t'i mbështesë.

- **Politika Evropiane e Fqinjësisë (ENP)**, e cila në rishikimin që iu bë në vitin 2015 merret me marrëdhënien midis vendeve evropiane dhe ato më të afërta fqinje. ENP-ja mund të përdoret edhe për ngritjen e kapaciteteve për çështjet e azilit në vendet partnere ⁽¹²⁾. Shumë fort e lidhur me të, **Politika Evropiane e Zgjerimit** ⁽¹³⁾ përbën kuadrin për të rritur angazhimin e BE-së me vendet kandidate dhe kandidate potenciale. Miratimi i **Strategjisë së Ballkanit Perëndimor** në vitin 2018 ⁽¹⁴⁾ pohon nevojën për bashkëpunim të përfortuar në fushat kyçe.
- **Agjenda Evropiane për Migracionin** ⁽¹⁵⁾, miratuar në vitin 2015, e cila propozon zgjidhje për menaxhim më të mirë të flukseve të migracionit drejt BE-së, qëndron mbi katër shtylla. Veprimtaria e EASO-s në dimensionin e jashtëm të CEAS është pjesë e shtyllës së tretë të Agjendës Evropiane për Migracionin.

- **Plani i Përbashkët të Veprimit të Valeta-s (JVAP)** ⁽¹⁶⁾ miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të Evropës dhe Afrikës në nëntor 2015 gjatë Samitit të Valeta-s për Migracionin. Sipas rekomandimeve të Procesit të Rabat-it dhe atij të Khartum-it, konkluzionet e përbashkëta të JVAP-së përsërisin angazhimin e të gjitha palëve të interesuara të përfshira për të trajtuar së bashku sfidat dhe mundësitë e migracionit. Brenda përparësisë së tretë të planit të veprimit “mbrojtje dhe azil”, EASO luan rol mbështetës për ngritjen e kapaciteteve në vendet e treta për sistemet e azilit dhe pritjes.

- **Udhërrëfyese i Komisionit Evropian për Migracionin**, i cili u prezantua gjatë përgatitjeve për mbledhjen e Këshillit Evropian në dhjetor 2017 ⁽¹⁷⁾. Komisioni pranoi se dimensionin e jashtëm të politikave të migracionit duhet të konsolidohet dhe përfortohet, kryesisht përmes zbatimit të plotë të Deklaratës BE-Turqi, për të cilën EASO ka dhënë kontribut aktiv duke mbështetur përpjekjet për zhvendosje të vendeve BE+ dhe angazhimin me vendet e treta partnere dhe agjencitë e OKB-së.

Në nivel global, Kompakti Global për Refugjatët (GCR) ⁽¹⁸⁾ merr rëndësi të veçantë për veprimtarinë e jashtme të EASO-s, përfshirë këtu thirrjen për zgjerimin e zhvendosjes dhe formave të tjera të pranimit ligjor.

⁽¹¹⁾ Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve. Agjenda Evropiane për Migracionin [COM (2015) 240 final]; Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve. Qasja Globale për Migracionin dhe Lëvizshmërinë [COM (2011) 743 final].

⁽¹²⁾ Komunikim i Përbashkët për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Rishikim i Politikës Evropiane të Fqinjësisë [JOIN (2015) 50 final].

⁽¹³⁾ https://ec.europa.eu/info/policies/eu-enlargement_en

⁽¹⁴⁾ Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian dhe Këshillin: Perspektiva e besueshme e zgjerimit dhe angazhimi i rritur i BE-së në Ballkanin Perëndimor, Strasburg, [COM(2018) 65 final]


⁽¹⁵⁾ Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve: Agjenda Evropiane për Migracionin [COM(2015) 240 final].

⁽¹⁶⁾ Samiti i Valeta-s për Migracionin, 11-12 nëntor 2015, Plani i Veprimit gjendet në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/11/12/valletta-final-docs>

⁽¹⁷⁾ Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian dhe Këshillin, kontributi i Komisionit për debatin tematik të Udhëheqësve të BE-së për rrugën përpara në dimensionin e jashtëm dhe të brendshëm të politikës së migracionit [COM (2017) 820 final].

⁽¹⁸⁾ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (APKB) më 17 dhjetor 2018.

5. KUADRI PËR ZBATIMIN E MBËSHTETJES



5.1. Parakushtet e angazhimit

Në pajtim me parimet udhëheqëse, duhet të plotësohen këto parakushte angazhimi për veprimin e jashtëm të EASO-s:

- Veprimi i jashtëm i EASO-s është në përputhje me mandatin e EASO-s, siç parashikohet në rregulloren për EASO-n;
- Veprimi i jashtëm i EASO-s krijon qartas vlerë të shtuar për politikën e jashtme të BE-së;
- Konsultimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me palët e interesuara, përfshirë vendet BE+, vendet e treta dhe Komisionin janë thelbësore për veprimin e jashtëm të EASO-s, prandaj ato janë shfrytëzuar dhe janë nxjerrë përfitime prej tyre;
- Në varësi të masës së parashikuar të mbështetjes, janë krijuar strategjitë e angazhimit, mosangazhimit dhe të qëndrueshmërisë së veprimtarisë së jashtme të EASO-s. Ato bazohen në plane specifike, të matshme, të arritshme, të orientuara drejt rezultatit dhe me afate (SMART);
- Vendi i tretë apo vendi BE+ që merr mbështetjen e EASO-s angazhohet të bashkëpunojë në mënyrë të ndershme të dhe hapur.

5.2. Procesi i angazhimit të EASO-s

EASO punon në aktivitete për mbështetjen e vendeve të treta dhe shpërnguljes me qëllim të realizimit të qëllimeve të veta shumëvjeçare⁽¹⁹⁾, të miratuar nga Bordi i Menaxhimit, në pajtim me shtrirjen dhe përparësitë gjeografike (seksioni 5.3) dhe bazuar në kuadrin e zbatimit të mbështetjes që përshkruhet në këtë strategji.

Veprimi i jashtëm i EASO-s mund të vihet në lëvizje nga kërkesat ad-hoc të Komisionit, nga kërkesat e vendeve BE+ përmes Bordit të Menaxhimit të EASO-s, ose nga vendet e treta.

Angazhimi i EASO-s përcaktohet:

- Duke informuar, në konsultim me ose pa miratimin e Bordit të Menaxhimit të EASO-s, sipas rastit;
- Në konsultim me Rrjetin e Dimensionit të Jashtëm të EASO-s;
- Në konsultim me Komisionin, në pajtim me kuadrin strategjik dhe operacional për veprimin e jashtëm të përcaktuar në marrëveshjet e punës midis Drejtorisë së Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme (DP për migrim dhe çështje të brendshme) dhe EASO-s⁽²⁰⁾;
- Në konsultim me palët e tjera të interesuara me anë të takimeve dhe shkëmbimeve të rregullta të informacionit.

Në pajtim me parimet e saj udhëheqëse, EASO do të kryejë vlerësimin e nevojave dhe/ose të realizueshmërisë në bashkëpunim me Komisionin, vendet BE+, vendet e treta dhe palët e tjera të interesuara përkatëse. Këto vlerësime do të bazohen në tre qasje plotësuese: normative, të bazuara në nevoja dhe të orientuara nga kërkesa. Ato mund të kryhen gjatë shqyrtimit të dosjeve, gjatë misioneve në vendet e treta përkatëse dhe me konsultime dhe takime me palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse. Para angazhimit do të merren parasysh të dhënat dhe raportet në dispozicion në EASO. Për të vlerësuar paraprakisht nevojën dhe përshtatshmërinë e veprimit të jashtëm të EASO-s, mund të përdoren raportet përkatëse nga vendet BE+, nga vendet e treta, institucionet dhe agjencitë e BE-së, organizata ndërkombëtare dhe organizata e shoqërisë civile.

⁽¹⁹⁾ Siç përcaktohet në dokumentet unike të programimit (SPD) të EASO-s dhe programet përkatëse vjetore të punës (AWP).

⁽²⁰⁾ Marrëveshjet e punës për bashkëpunimin në Veprimin e jashtëm midis Drejtorisë së Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme dhe EASO-s, nënshkruar në janar 2018.

Më pas, veprimi i jashtëm i EASO-s do të planifikohet, zbatohet dhe dokumentohet përmes instrumenteve të bashkëpunimit që ka në dispozicion (shih seksionin 5.5). Në varësi të masës dhe llojit të mbështetjes që duhet dhënë do të ngrihet dhe niveli përkatës i monitorimit dhe vlerësimit. EASO parashikon mundësinë e kombinimit të llojeve të mbështetjes sipas nevojës. EASO do ta informojë vazhdimisht Bordin e Menaxhimit për veprimin e jashtëm të EASO-s ⁽²¹⁾.

5.3. Përparësitë gjeografike

Përparësitë në angazhim dhe bashkëpunim



Në pajtim me mandatin që ka, veprimi i jashtëm i EASO-s mbështet dimensionin e jashtëm të CEAS dhe kontribuon në kuadrin e politikave të marrëdhënieve me jashtë të vendosura në nivel BE-je (shih seksionin 4). Për këtë qëllim, EASO synon të ruajë dhe forcojë angazhimin dhe bashkëpunimin me vendet e treta me përparësi kryesore, konkretisht me vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqinë, Lindjen e Mesme dhe vendet e Afrikës së Veriut (MENA).

Që prej vitit 2016, bashkëpunimi midis EASO-s dhe **vendeve të Ballkanit Perëndimor** është rritur edhe përmes zbatimit të një projekti rajonal të financuar nga IPA II ⁽²²⁾. Mbështetja e dhënë dhe vazhdimësia e saj në fazën e dytë të projektit (2019-2021) do të synojë drejtpërdrejt forcimin e sistemeve të pritjes dhe të azilit, harmonizimin e praktikave të azilit dhe shkëmbimin e ekspertizës në nivel rajonal. Këtu përfshihet mbështetja për rrjetet rajonale të profesionistëve dhe për Nismën Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI) si dhe harmonizimi i mëtejshëm me *acquis* të BE-së, me standardet evropiane dhe me zbatimin e tyre. Përveç kësaj, me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë janë në fuqi dy udhërrëfyes kombëtarë që do të rishikohen në 2019. Në kuadrin e fazës së dytë të projektit janë planifikuar të zhvillohen udhërrëfyes të tjerë kombëtarë.

Turqia është prekur rëndë nga strehimi i refugjatëve nga rajoni dhe në rang global shihet si vendi që ka pritur më shumë refugjatë. Kjo situatë ndikon dhe do të ndikojë te sistemi i menaxhimit të azilit dhe migracionit të Turqisë. Në vitin 2017 EASO forcoi bashkëpunimin e saj me Turqinë me anë të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të zhvilluara në bashkëpunim dhe lëvruar për Drejtorinë e Përgjithshme për Menaxhimin e Migracionit. Ky bashkëpunim u zhvillua me sukses nën strukturën e qasjes së udhërrëfyesit kombëtar. EASO parashikon të mbështesë edhe më tej zhvillimin cilësor të sistemeve të menaxhimit të azilit dhe migracionit nisur nga pozita gjeografike e Turqisë. Shkëmbimi i njohurive dhe ekspertizës së BE-së me Turqinë, parë nga një qasje e qëndrueshme, ka potencialin të çojë drejt një ndikimi të efektshëm dhe pozitiv që i qëndron kohës.

Në rajonin **MENA**, në periudhën 2014-2016, EASO ka zbatuar një projekt të financuar nga Instrumenti i Fqinjësisë dhe Partneritetit Evropian

⁽²¹⁾ Diskutime më të detajuara do të kryhen në kuadrin e Rrjetit të Dimensionit të Jashtëm dhe në pajtim me Marrëveshjet e Punës për Dimensionin e Jashtëm që janë në fuqi midis EASO-s, Drejtorisë së Përgjithshme për Migracionin dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Brendshme.

⁽²²⁾ Mbështetje Rajonale për Menaxhimin e Migracionit të Lidhur me Mbrojtjen në Ballkanin Perëndimor u zbatua nga shtatori 2016 deri në qershor 2019 me UNHCR-në, Agjencinë e Rojës Bregdetare dhe të Kufirit Evropian (Frontex) dhe IOM-in si partnerë.

(ENPI). Qëllimi ishte që zyrtarët e Jordanisë, Marokut dhe Tunizisë të familjarizoheshin me mandatin, mjetet dhe instrumentet e EASO-s dhe të Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe të Kufirit Evropian (Frontex) si dhe me modelet e bashkëpunimit të zhvilluara me vendet BE+, ndërkohë që vlerësohen nevojat teknike të vendeve të treta që përdorin mjetet e EASO-s dhe Frontex-it për t'iu përgjigjur nevojave për ngritjen e kapaciteteve. Që nga fundi i projektit u përdorën mësimet e nxjerra si dhe u bënë ndërhyrje më të synuara në rajonin e MENA-s.

Përcaktimi i përparësive të reja

Në rastet kur veprimi i jashtëm i EASO-s mund të aktivizohet me kërkesë të bërë sipas seksionit 5.2 dhe me kusht që kërkesa të jetë në pajtim me kuadrin e politikave të marrëdhënieve të jashtme të BE-së (seksioni 3), përparësitë për

angazhimin dhe/ose mosangazhimin në veprime të jashtme do të bazohen:

- te përparësitë e BE-së (aktuale dhe ato që dalin përpara);
- te nevojat e vendeve BE+ dhe/ose vendeve të treta;
- te koherenca kundrejt ekspertizës së EASO-s;
- te kapaciteti i EASO-s për të ndikuar dhe shtuar vlerë në mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme.

Përparësitë për angazhimin dhe/ose mosangazhimin do të vlerësohen duke zbatuar metodologjinë e menaxhimit të ciklit të projektit të EASO-s, përshtatur për masën dhe llojin e mbështetjes që do të jepet dhe në pajtim me parimet udhëheqëse, me parakushtet dhe me procesin e përshkruar të angazhimit të EASO-s.



5.4. Llojet e veprimit të jashtëm të EASO-s

Në pajtim me rregulloren dhe parimet udhëheqëse të EASO-s (seksioni 3), veprimi i jashtëm i EASO-s mund të marrë një ose disa nga format e përmendura më poshtë. Ky veprim pasqyron natyrën dhe llojin e ndryshëm të angazhimit, në varësi të nevojës së vlerësuar, të interesave të shprehura nga Bordi i Menaxhimit, nga vendet BE+ dhe nga vendet e treta si dhe

nga kapaciteti dhe ekspertiza e EASO-s. Për të formuar një strategji gjithëpërfshirëse mbështetjeje për vendet BE+ dhe/ose vendet e treta mund të kombinohen disa lloje veprimesh.

Gjithashtu, EASO do të vazhdojë të mbështesë zbatimin e nismave evropiane, ndërkombëtare dhe rajonale dhe të kornizave për migracionin dhe azilin duke kontribuar për forumet shumëpalëshe dhe dialogun, brenda fushëveprimit të burimeve të saj.

<p>Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit</p>	<p>EASO do të ndihmojë shkëmbimin e informacionit për veprimet e zhvendosjes dhe rrugët e tjera ligjore të mbrojtjes ndërkombëtare midis vendeve BE+, përmes rolit të saj bashkërendues, duke synuar të mbështesë vendet BE+ për zbatimin e angazhimeve të tyre kundrejt solidaritetit ndërkombëtar dhe për dhënien e kontributit për krijimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. EASO do të nxisë dhe ndihmojë shkëmbimin e informacionit për veprimin e vendeve BE+ në vendet e treta, duke e mbledhur këtë informacion, me qëllim që të ndihmojë bashkëpunimin teknik për çështjet që lidhen me azilin dhe refugjatët. Kjo gjë do të bëhet edhe duke dhënë ekspertizë të bazuar në metodologjinë e saj për menaxhimin e informacionit.</p>
<p>Ngritja e kapaciteteve dhe e njohurive</p>	<p>EASO do të mbështesë krijimin, zhvillimin dhe/ose forcimin e sistemeve të azilit dhe pritjes të vendeve të treta duke u dhënë mbështetje për ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive. Mbështetja do të bazohet te ekspertiza e vendeve BE+ dhe e EASO-s, përcaktuar me një qasje midis homologësh dhe duke marrë parasysh kontekstin kombëtar dhe/ose ndërkombëtar (mbështetje e bazuar në skenarë ⁽²³⁾). Në vendet e treta EASO do të angazhohet me instrumentet e duhura të bashkëpunimit (seksioni 5.5) dhe me marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit (seksioni 5.6).</p> <p>Llojet kryesore të aktiviteteve që do të kryhen do të jenë trajnimi (qoftë sipas programit të trajnimit të EASO-s, qoftë me trajnime operationale të hartuara enkas), konferencat, vizitat studimore, punëtoritë trajnimi në vendin e punës, asistenca teknike, dhënia e kontributit dhe këshillave për politikën, ndarja e njohurive për praktikën dhe mësimet e nxjerra.</p> <p>Asistenca teknike në fushën e azilit përforcon dhe ndihmon veprimin e EASO-s për ngritjen e kapaciteteve. EASO do të japë ekspertizë teknike me anë të instrumenteve të bashkëpunimit që disponon dhe me kusht që të përmbushen parakushtet për angazhimin e saj. Asistenca teknike mund të përfshijë shfrytëzimin e mjeteve ekzistuese të EASO-s të përshtatura në kontekstin e një vendi të tretë të dhënë, duke përkthyer dhe/ose përshtatur produktet përkatëse të EASO-s, duke u lehtësuar pjesëmarrjen në takimet tematike vëzhguesve nga vendet e treta, sipas rastit dhe rëndësisë.</p>

⁽²³⁾ Qasja e mbështetjes së bazuar në skenarë parashikon se lloji i mbështetjes zbatohet me instrumentet e duhura të bashkëpunimit dhe i përshtatet kontekstit kombëtar dhe/ose rajonal ku përfshihen kuadrot institucionale dhe legjislative në fuqi.

Bashkëpunimi operacional

EASO do të konsiderojë lehtësimin e bashkëpunimit operacional midis vendeve BE+ dhe vendeve të treta duke u dhënë mbështetje operationale specifike, sipas rastit, përmes instrumenteve të bashkëpunimit që ka në dispozicion dhe me kusht që të përmbushen parakushtet për angazhim, në pajtim me politikën e jashtme të BE-së, dhe pasi të miratohet nga Bordi i Menaxhimit.

Bashkëpunimi i mundur operacional mund të konsiderohet në rastet kur mbështetja e krijuar për ngritjen e kapaciteteve, bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit midis EASO-s dhe vendeve BE+, vendeve të treta dhe palëve të tjera të interesuara ka thelluar marrëdhëniet me vendin e tretë, duke çuar kështu drejt identifikimit të vlerës së shtuar për të trajtuar nevoja të reja. Mbështetja operationale do të vlerësohet dhe testohet në mbështetje të zhvendosjes, ku do të kontribuojë potencialisht në përpjekjet e vendeve BE+ dhe do t'u shtojë vlerë skemave kombëtare ose të BE-së për shpërnguljen.

Për këtë qëllim, prania specifike e EASO-s në vende të treta kyçe ⁽²⁴⁾ mund të fuqizojë veprimin e jashtëm të EASO-s, mund edhe të lehtësojë bashkëpunimin teknik, zbatimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve të mbështetjes përmes bashkërendimit me autoritetet kryesore dhe partnerët në atë fushë. Prania e EASO-s në vendin e tretë duhet të ketë objektiva të qarta që plotësojnë dhe i shtojnë vlerë punës së kryer në Zyrat qendrore të EASO-s.

⁽²⁴⁾ EASO aktualisht mbështet punën e Ekipit për Politikën Evropiane për Migracionin në Delegacionin e Bashkimit Evropian (EUD) në Ankara, Turqi duke caktuar atje një ekspert për Zhvendosjen. Rekrutimi i Specialistit Operacional për menaxhimin e Projektit Pilot për Qendrën e Mbështetjes për Zhvendosjen në Turqi (me bazë në Maltë por me mision të shpeshta në Turqi) është në proces. Përveç kësaj, Faza II e projektit IPA (2019-2021) parashikon praninë e një specialisti terreni në Ballkanin Perëndimor. Projekt rregullorja për EUAA-në parashikon Specialistë Ndërlidhjeje. Prania e tyre do të parashikohet pasi të hyjë në fuqi rregullorja për EUAA-në.

5.5. Instrumentet e bashkëpunimit

Për të përmbushur objektivat e veprimit të saj të jashtëm EASO do të bëjë përpjekje të përdorë sa më mirë instrumentet që ka në dispozicion. Instrumentet e bashkëpunimit të EASO-s sjellin pas vetes shkallë të ndryshme përfshirjeje dhe mbështetjeje. EASO do të përdorë instrumentin më të përshtatshëm për të përshtatur sipas nevojës dhe do të ofrojë llojin e duhur të mbështetjes së EASO-s, përcaktuar nga përparësitë gjeografike (mbështetja e bazuar në skenarë).

Të gjithë instrumentet bëjnë pjesë në një qasje më të gjerë për menaxhimin e ciklit të projektit në EASO, që i ndan programet (3 vite e më shumë) nga projektet (afat më i shkurtër). Projektet përfshijnë planet operative, planet e veçanta të mbështetjes, udhërrëfyesit kombëtarë të vendeve të treta etj; në pajtim me Manualin Operacional të EASO-s ⁽²⁵⁾.

Instrumentet e bashkëpunimit përfshijnë:

- **Ndërrhyrjet specifike:** Ndërrhyrjet ad-hoc dhe specifike do të përdoren për të nisur bashkëpunimin dhe/ose trajtuar nevoja shumë specifike të vendeve të treta, në pajtim me kuadrin e politikës së jashtme të BE-së dhe sipas marrëveshjes specifike me Komisionin. Bazuar në shqyrtimin e rezultateve të ndërrhyrjeve specifike aktivitetet e zbatuara mund të kthehen në bashkëpunim më formal (p.sh. duke ngritur një projekt ose udhërrëfyes kombëtar).
- **Projektet:** Për të arritur qëllime specifike, pilotuar aktivitete dhe/ose testuar qasje të reja EASO do të zhvillojë projekte specifike dhe me afate në fushat përgjatë procesit të azilit dhe pritjes, zhvendosjes dhe rrugëve të tjera ligjore për mbrojtje ndërkombëtare, sipas nevojave të vlerësuara dhe në pajtim me kontekstet specifike. EASO do të synojë të përfshijë partnerët kyçë për të arritur

rezultatet e nevojshme dhe do të krijojë kanale të përforcuara komunikimi për të siguruar bashkëpunim të mirë në kuadrin e aktiviteteve më të gjera të komunikimit të EASO-s. EASO do të ketë edhe mundësinë të zbatojë projekte të financuara nga jashtë (shih seksionin 5.6 për financimet).

- Mjetet e bashkëpunimit si **Udhërrëfyesit kombëtarë dhe rajonalë**, të bazuar në përparësitë e identifikuar të politikave të jashtme të BE-së dhe në konsultim me Bordin e Menaxhimit të EASO-s, nevojat e identifikuar dhe përparësitë vijuese duke detajuar llojin e mbështetjes që kjo ndërhyrje do të japë. Ata mundësojnë planifikimin e aktiviteteve mbështetëse në fushat kyçe për bashkëpunim gjatë gjithë procesit të azilit dhe të pritjes, të zhvendosjes dhe rrugëve të tjera ligjore, sipas nevojave specifike dhe në pajtim me kontekstet specifike. Ata zhvillohen nga EASO bashkë me autoritetet kombëtare të vendeve të treta me një qasje pjesëmarrëse, në bashkëpunim dhe bashkërendim me të gjitha palët e interesuara, përfshirë vendet BE+, institucionet dhe agjencitë e BE-së, organizatat e migracionit si UNHCR-ja dhe IOM-i. Ekziston edhe mundësia e hartimit të udhërrëfyesve rajonalë ose tematikë me disa vende BE+, vende të treta ose nisma rajonale.

Përveç kësaj, EASO ka ngritur një **rrjet** për komunikimin me vendet BE+, me Komisionin, me Shërbimin për Veprimin e Jashtëm të BE-së (EEAS), me rrjetin e agjencive përkatëse të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme të BE-së dhe kur është nevoja me organizatat e migracionit, organizatat jo-fitimprurëse (OJF) dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për çështjet që lidhen me veprimin e jashtëm të EASO-s. Roli i rrjetit do të zbatojë termat e referencës që do të përcaktohen. EASO do të inkurajojë dialogun midis rrjeteve të tjera të EASO-s dhe zyrtarëve të vendeve të treta, kur është e përshtatshme dhe e nevojshme, duke

⁽²⁵⁾ Shih shënimin 7 në fund të faqes.

krijuar raste për të mësuar dhe për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat e mira.

5.6. Marrëveshjet e bashkëpunimit

Marrëveshjet midis EASO-s, vendeve BE+, autoriteteve të vendeve të treta ose palëve të tjera të interesuara shprehin angazhimin për të bashkëpunuar dhe përcaktuar mënyrat e këtij bashkëpunimi, duke e pajisur EASO-n me kuadrin për të kryer veprimet e saj mbështetëse dhe për të zyrtarizuar instrumentet e bashkëpunimit. Këtu përfshihen::

- **Korrespondenca me shkrim, shkëmbimi i letrave dhe/ose deklaratave të qëllimit**, të cilat janë angazhime formale në një nivel të caktuar që kanë për synim të mbështesin zyrtarisht bashkëpunimin midis EASO-s dhe palëve të interesuara.
- **Marrëveshjet e punës me vendet e treta**, të cilat krijojnë angazhim të nivelit të lartë dhe një kuadër bashkëpunimi me autoritetet e një vendi të tretë i cili është kompetent në fushat që lidhen me mandatin e EASO-s. Në pajtim me rregulloren e saj, EASO mund të nënshkruajë marrëveshje pune me vendet e treta për të ndihmuar zbatimin e veprimit të saj të jashtëm, në marrëveshje me Komisionin dhe me vendim të Bordit të Menaxhimit të EASO-s. Ky vendim përcakton natyrën, masën dhe mënyrën në të cilën do të zbatohet bashkëpunimi midis agjencisë dhe vendit në fjalë, përfshirë këtu bashkëpunimin për aspektet teknike sipas mbulimit të bërë nga rregullorja e EASO-s.

Marrëveshjet e punës mund të përdoren për bashkëpunimet e qëndrueshme dhe afatgjata me vendet e treta, me kusht që ato t'i shtojnë vlerë zbatimit të mbështetjes.

- **Marrëveshjet e punës me institucionet dhe agjencitë e BE-së, me organizatat e migracionit dhe palët e tjera të interesuara**, të cilat krijojnë kuadrin e bashkëpunimit dhe komunikimit që mund të përfshihet ose përqendrohet në dimensionin e jashtëm të BE-së.

5.7. Financimi

Veprimi i jashtëm i EASO-s financohet kryesisht nga **buxheti i EASO-s** (shuma e financimit që i caktohet dimensionit të jashtëm vendoset në programin vjetor të punës së EASO-s) ⁽²⁶⁾.

Përveç këtij burimi kryesor financimi, veprimi i jashtëm i EASO-s mund të financohet edhe nga **instrumentet e BE-së për ndihmën e jashtme**. Kështu, në veprimin e saj të jashtëm EASO do të konsiderojë instrumentet financiare të BE-së, si Instrumenti Evropian i Fqinjësisë (ENI), Instrumenti për Para-Anëtarësimin (IPA) dhe programet përkatëse rajonale të zhvillimit dhe të mbrojtjes (RDPP), në bashkëpunim me Komisionin dhe organet e tjera të BE-së. Projektet dhe partneritetet do të zhvillohen në pajtim me parimet udhëheqëse.

Së fundmi, vendet BE+ mund të **kontribuojnë vullnetarisht** në buxhetin e EASO-s për projekte specifike.

⁽²⁶⁾ Buron nga kontributi i BE-së në buxhetin e EASO-s, nga kontributi vullnetar i Shteteve Anëtare për EASO-n dhe nga kontributi i Shteteve të Asociuara me EASO-n.

6. BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA

Duke qenë se bashkëpunimi i jashtëm i EASO-s synon të krijojë vlerë të shtuar, do të merren masa që të mos dublohen përpjekjet e kryera individualisht nga vendet BE+, nga Komisioni, EEAS dhe përfshirë Delegacionet e BE-së, agjenci të tjera të BE-së të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme dhe palët e tjera të interesuara. Sa herë të shihet e arsyeshme dhe është arritur bashkëveprimi, EASO mund të konsiderojë që të bëhet partner me vendet e veçanta BE+, me Komisionin, EEAS, me agjencitë e BE-së për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme dhe/ose organizatat e migracionit për të mbështetur vende të treta të caktuara.

6.1. *Vendet BE+*

Në pajtim me përparësitë e tyre kombëtare për punët e jashtme, brenda kuadrit të CEAS, vendet BE+ kanë bashkëpunim të vazhdueshëm dypalësh me vendet e treta në fushën e azilit dhe të migracionit. Aktivitetet e vendeve BE+ plotësojnë ato të EASO-s dhe mund të marrin forma të ndryshme si marrëveshje dypalëshe, programe binjakëzimi dhe asistencë teknike për vendet e treta.

Angazhimi i vendeve BE+ në Strategjinë e EASO-s për Bashkëpunimin e Jashtëm është i domosdoshëm për suksesin e veprimeve të jashtme përkatëse të EASO-s.

6.2. *Vendet e treta*

Vendet e treta janë partnerë thelbësorë për EASO-n në zbatimin e Dimensionit të Jashtëm

të CEAS. Fushat e bashkëpunimit me vendet e treta do të identifikohen gjatë gjithë procesit të azilit, sipas kërkesave dhe interesave të autoriteteve kombëtare. Ndërhyrjet e synuara të EASO-s, udhërrëfyesit kombëtarë dhe/ose bashkëpunimi operacional do të zhvillohet në mënyrë të përbashkët duke përdorur qasjen e pjesëmarrjes dhe komunikimin e hapur me dy kahje. Kjo gjë do të bëjë të mundur rritjen e partneritetit dhe përshtatshmërisë me nevojat dhe burimet nga të dy anët.

6.3. *Institucionet dhe agjencitë evropiane*

Komisioni Evropian

Drejtoria e Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme është partner thelbësor i EASO-s në punën e saj për zbatimin e dimensionit të jashtëm të CEAS. Marrëveshja e punës për veprimin e jashtëm midis kësaj drejtorie dhe EASO-s ngre kuadrin strategjik dhe operacional të bashkëpunimit dhe komunikimit për veprimin e jashtëm duke u përqendruar në përcaktimin e përparësive, në programimin e veprimit të jashtëm dhe bashkëpunimin me vendet e treta.

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit është një tjetër partner kyç i EASO-s për shkak të kompetencës gjeografike që i është dhënë. Bashkëpunimi është krijuar kryesisht në kuadrin e Projektit IPA dhe do të forcohet në pajtim me përparësitë gjeografike.



Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile Evropiane dhe Veprimeve të Ndhmës Humanitare (ECHO), në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme, mund të angazhohen sipas rastit në zbatimin e veprimit të jashtëm të EASO-s duke shkëmbyer informacione për instrumentet e bashkëpunimit të EASO-s që mund të ndikojnë në punën e tyre.

Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian (EEAS)

EEAS do të angazhohet aty ku shihet e përshtatshme në përcaktimin ⁽²⁷⁾ dhe zbatimin e veprimit të jashtëm të EASO-s. EASO aktualisht kontribuon në punën e Ekipit të Politikave të Migracionit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Turqi duke caktuar atje një ekspert për shpërnguljen. Në mënyrë të ngjashme, EASO do të përpiqet të bashkëpunojë ngushtësisht me Delegacionet e BE-së në vendet e treta ku kryhet veprimi i jashtëm i EASO-s.

Delegacionet e BE-së do të informohen rregullisht për aktivitetet mbështetëse që EASO kryen në vendet e treta si dhe mund të organizohen takime informuese dhe raportuese me personelin e EASO-s dhe me ekspertët e caktuar në këto vende. Kur shihet e arsyeshme dhe me kërkesën e EASO-s, Delegacionet e BE-së mund t'i japin EASO-s mbështetje logjistike dhe informacion të përditësuar për vendin e tretë në fjalë.

Agjencitë e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme dhe rrjeti i tyre

Agjencitë e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme (JHA) luajnë individualisht dhe kolektivisht rol domethënës në zbatimin e veprimit të jashtëm të BE-së. Ashtu si EASO, disa nga agjencitë e tjera të BE-së për Drejtësi dhe Çështje tjera, kanë jo vetëm mandatin ligjor për bashkëpunimin e jashtëm, por kanë edhe ekspertizën e nevojshme në disa fusha me rëndësi pasi ato vazhdimisht përdorin resurset

e vendeve BE+ dhe praktikat, standardet dhe njohuritë ndërkombëtare. Prandaj EASO ka krijuar marrëdhënie pune me Frontex-in, Agjencinë për të Drejtat Themelore (FRA) dhe me Europol-in, punon me rrjetin e Agjencive për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme dhe bashkëpunon në nivel operacional, për shembull në Ballkanin Perëndimor. EASO ka nënshkruar marrëveshje pune me Frontex-in dhe FRA-në dhe po diskuton po ashtu me Europol-in.

Brenda rrjetit të agjencive për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme, EASO shkëmben mendimet dhe përvojën me agjencitë e tjera për punën e tyre në fushën e bashkëpunimit me vendet e treta, brenda mandateve ekzistuese të agjencive, dhe rrit bashkërendimin e punës së tyre në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin dhe EEAS, të cilët po ashtu janë pjesë e rrjetit.

6.4. Organizatat ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara kyçe

Organizatat ndërkombëtare

UNHCR-ja është partner thelbësor për EASO-n në punën e saj mbështetëse ndaj vendeve BE+ për përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadrin e azilit dhe refugjatëve, sipas legjislacionit të BE-së dhe atij ndërkombëtar. Sipas Nenit 78 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), CEAS i Bashkimit Evropian do të përfshijë partneritetin dhe bashkëpunimin me vendet e treta me qëllim menaxhimin e fluksit hyrës të personave që kërkojnë azil ose mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, gjë që duhet të bëhet në pajtim me Konventën e Gjenevës të 28 korrikut 1951, me Protokollin e 31 janarit 1967 për statusin e refugjatit dhe me traktate të tjera të rëndësishme. Marrëveshja e punës midis EASO-s dhe UNHCR-së përcakton kuadrin e bashkëpunimit midis këtyre dy organizatave. Nenet 13 dhe 14 përqendrohen në mënyrë të veçantë te mbështetja dhe zhvendosja në vendet

⁽²⁷⁾ EEAS iu mor mendimi për projektin e Strategjisë EASO-s për Bashkëpunimin e Jashtëm të EASO-s më 31 janar 2019 (konsultim dypalësh) dhe më 1 shkurt 2019 (konsultim shumëpalësh).

e treta, duke krijuar kuadrin për shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira në këto fusha dhe duke parë mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm ⁽²⁸⁾.

IOM-i është një tjetër palë e interesuar me shumë rëndësi në fushën e migracionit, veçanërisht në fushën e zhvendosjes. EASO dhe IOM aktualisht po diskutojnë si të rrisin bashkëpunimin ⁽²⁹⁾.

Organizatat jo-fitimprurëse (OJF-të), organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe nismat e tjera rajonale dhe tematike

Aty ku e sheh të arsyeshme EASO mund edhe të angazhohet me OJF-të ose OSHC-të e specializuara dhe me nismat e tjera rajonale dhe/ose tematike në zona të caktuara.

Shumë OJF dhe OSHC që punojnë në fushën e azilit kanë përvojë të veçantë dhe ekspertizë

operacionale që nuk e kanë vendet BE+ dhe institucionet e BE-së. Aty ku është me vend, EASO përpaket të bashkëpunojë me to për veprime të jashtme specifike me vendet e treta ose për shpërnguljen. EASO do të vazhdojë të marrë mendimin e OJF-ve dhe OSHC-ve ku ta shohë të përshtatshme dhe në përputhje me ekspertizën e tyre tematike ose gjeografike gjatë misioneve në terren në vendet e treta dhe/ose për shpërnguljen.

Nismat e tjera rajonale dhe tematike përfshijnë partneritetin midis aktorëve të ndryshëm (OJF-të, OSHC-të, shtetet, universitetet, sektori privat), të cilët mund të plotësojnë ose të rrisin ndikimin e veprimit të jashtëm të EASO-s. Këto nisma përfshijnë Nismën Globale për Mbështetjen e Refugjatëve (GRSI), MARRI-n dhe Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE).

7. PLANIFIKIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

7.1. Kuadri kohor

Kjo Strategji e EASO-s për Bashkëpunimin në Veprimin e Jashtëm është në pajtim me mandatin e EASO-s, prandaj nuk ka afate të përcaktuara. Strategjia do të bëhet operacionale në përputhje me ciklin e brendshëm të planifikimit të EASO-s, përmes dokumenteve unike të programimit (SPD) dhe planeve vjetore të punës (AWP).

Strategjia mund të rishikohet nëse ndodhin këto rrethana:

- Miratohen instrumentet e reja legjislative dhe politike që ndikojnë në punën e EASO-s si dhe propozimet legjislative që kanë për qëllim themelimin e agjencisë të mirëfilltë EUAA;

- Ndryshime domethënëse në kontekstin e migracionit dhe të azilit ndikojnë në përparësitë me jashtë të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian;
- Ndryshime domethënëse në situatën e vendeve të treta ndikojnë në veprimin aktual të jashtëm të EASO-s.

7.2. Metodologjia e planifikimit

Strategjia e EASO-s për Bashkëpunimin e Jashtëm do të japë drejtim strategjik edhe për zhvillimin e kornizave të rezultateve të cilat do të bazohen në kombinimin e dy qasjeve: qasja e menaxhimit bazuar në rezultate dhe qasja e teorisë së ndryshimit. Ajo do të përbëjë bazën

⁽²⁸⁾ Marrëveshja e punës midis EASO-s dhe UNHCR-së gjendet këtu: https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/EASO-UNHCR-Working-Arrangement_0.pdf. UNHCR-së iu mor mendimi për përcaktimin e Strategjisë së EASO-s për Bashkëpunimin e Jashtëm në takimin dypalësh më 31 janar si dhe në takimin e datës 1 shkurt 2019.

⁽²⁹⁾ Në kohën kur po shkruhej ky dokument po diskutohej një marrëveshje pune midis IOM-it dhe EASO-s. IOM-it iu mor mendimi në takimin dypalësh më 31 janar.

për qasjen disa vjeçare, përfshirë rishikimin dhe vlerësimin.

7.3. Monitorimi dhe vlerësimi

Angazhimi i EASO-s me vendet BE+ dhe vendet e treta do të mbështetet nga monitorimi

i besnikërisë dhe nga nismat e vlerësimit të përshtatur të EASO-s. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihet në instrumentet përkatëse të bashkëpunimit aty ku shihet e përshtatshme dhe duke marrë parasysh qasjen e bazuar në skenarë. Zbatimi i këtyre funksioneve do të mbështetet nga personel i caktuar enkas për monitorimin dhe vlerësimin.

Getting in touch with the EU

In person

All over the European Union there are hundreds of Europe Direct information centres. You can find the address of the centre nearest you at: <http://europa.eu/contact>

On the phone or by email

Europe Direct is a service that answers your questions about the European Union. You can contact this service:

- by freephone: 00 800 6 7 8 9 10 11 (certain operators may charge for these calls),
- at the following standard number: +32 22999696 or
- by email via: <http://europa.eu/contact>

Finding information about the EU

Online

Information about the European Union in all the official languages of the EU is available on the Europa website at: <http://europa.eu>

EU publications

You can download or order free and priced EU publications from EU Bookshop at: <http://publications.europa.eu/eubookshop>. Multiple copies of free publications may be obtained by contacting Europe Direct or your local information centre (see <http://europa.eu/contact>).

EU law and related documents

For access to legal information from the EU, including all EU law since 1951 in all the official language versions, go to EUR-Lex at: <http://eur-lex.europa.eu>

Open data from the EU

The EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp>) provides access to datasets from the EU. Data can be downloaded and reused for free, both for commercial and non-commercial purposes.



Publications Office
of the European Union